**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***
***Centralna Izborna Komisija***
***Central Election Commission***

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
12 -01- 2024
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01/19 - 2024

**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA,** u skladu sa ovlašćenjima datim članom 63, članom 64.2 kao i članom 113 Zakona br. 08/L-228 o opštim izborima u Republici Kosovo, kao i u skladu sa članom 8 Zakona br. 04/L-042 o javnim nabavkama u Republici Kosovo, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-237, Zakonom br.05/L-068 i Zakonom br.05/L-092, na redovnom sastanku održanom 12.01.2024, donosi:

**ODLUKA**

**O usvajanju Plana nabavke za 2024. godinu**

I. Usvaja se Plan nabavke za 2024. godinu.

II. Plan kao u tački I, sastavni je deo ove odluke.

III. Obavezuje se Sekretarijat CIK-a za sprovođenje ove odluke.

IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**Priština, 12.01.2024**

**Predsedavajući**

**Centralna izborna komisija**

**Kreshnik Radoniqi**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Komisioni Qendror i Zgjedhjeve***
***Centralna Izborna Komisija***
***Central Election Commission***

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission
12 -01- 2024
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01120 - 2024

**CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA,** u skladu sa ovlašćenjima datim članom 63 i 64.2 Zakona br.08/L-228 o Opštim izborima u Republici Kosovo, na redovnoj sednici održanoj 12.01.2024, donosi:

**ODLUKA**

**O usvajanju Plana rada za 2024. godinu**

I. Usvaja se Plan rada za 2024. godinu.

II. Plan kao u tački I, je sastavni deo ove odluke.

III. Obavezuje se Sekretarijat za sprovođenje ove odluke.

IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

**Priština, 12.01.2024**

**Predsedavajući**

**Centralna izborna komisija**

**Kreshnik Radoniqi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*
*Centralna Izborna Komisija*
*Central Election Commission*

# PLANI PUNËS I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2024

**PËRMBAJTJA**


1 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KQZ-SË ..... 5

1.1 Baza ligjore ..... 5

1.2 Mandati i KQZ-së ..... 5

1.3 Përbërja dhe struktura KQZ-së ..... 6

1.4 Sekretariati i KQZ-së ..... 6

1.5 Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFPP) ..... 6

1.6 Komisionet Komunale të Zgjedhjeve ..... 6

2 PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË PUNËS - METODOLOGJIA ..... 7

3 PLANI I PUNËS SIPAS SHTYLLAVE STRATEGJIKE TË KQZ-së ..... 8

4 Raportimi ..... 8

**HYRJE**

Plani i Punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të Republikës së Kosovës (Plani i Punës) paraqet tërësinë e aktiviteteve që do të zbatohen në vitin 2024. Ky Plan i Punës bazohet në orientimet strategjike të KQZ të vendosura në Planin Strategjik 2023 - 2026. Aktivitetet e parashikuara në Planin e Punës janë, po ashtu, në përputhje me parimet orientuese të punës të shprehura në të gjitha dokumentet e KQZ-së, si analizat e ndryshme dhe konkluzionet nga mësimet e nxëna nga proceset zgjedhore.

Rrjedhimisht, të gjitha aktivitetet e parapara kontribuojnë në zbatimin e misionit të KQZ-së dhe në arritjen e objektivave të saj.

Plani i Punës është hartuar mbi bazën të diskutimeve dhe me përfshirjen e të gjitha njësive strukturore të KQZ-së si dhe parterëve të jashtëm. Për më tepër, gjatë hartimit të këtij dokumenti janë konsultuar edhe rekomandimet e misioneve vendore dhe ndërkombëtare vëzhguese të zgjedhjeve.

Plani i Punës paraqet një dokument të integruar, për të cilin KQZ bie dakord për aktivitetet kryesore që KQZ duhet të zbatojë gjatë vitit 224, me qëllim të arritjes së objektivave dhe orientimeve strategjike zhvillimore. Plani i Punës gjithashtu planifikon shpërndarje efektive të burimeve njerëzore të KQZ-së për të arritur objektivat e veta. Së bashku me arritjen e objektivave strategjike të KQZ-së, zhvillimi i Plani i Punës shërben, gjithashtu, për të mbështetur procesin e planifikimit dhe menaxhimit të aktiviteteve të KQZ-së për të ardhmen e sidomos duke pasur parasysh që Zgjedhjet Lokale do të mbahen këtë vit, e Plani i Punës parashikon aktivitete që mund të përmirësojnë atë proces zgjedhor.

Për fund, Plani i Punës i KQZ-së është hartuar sipas metodologjisë standarde të KQZ-së për hartimin, aprovimin, korrigjimin dhe zbatimin e planeve vjetor të punës dhe të cilat miratohen nga KQZ-ja.

Dokumenti përfundimtar i Plani i Punës është rezultat i punës së përbashkët të njësive strukturore të KQZ-së. Dokumenti thekson qartë objektivat strategjike, aktivitetet e planifikuara për të arritur këto objektiva, treguesit e matshëm, rezultatet e pritura, burimet si dhe përcakton njësitë strukturore dhe personat përgjegjës.

**LISTA E SHKURTESAVE**

| | |
|---|---|
| **KKZ** | Komisionet Komunale të Zgjedhjeve |
| **KQZ** | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| **KVV** | Këshillat e vendvotimeve |
| **OJQ** | Organizatat Jo Qeveritare |
| **OSBE** | Organizata për siguri dhe bashkëpunim ne Evropë |
| **QNR** | Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve |
| **QV** | Qendra e Votimit |
| **SKQZ** | Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve |
| **VV** | Vendvotim |
| **SHV** | Shërbimi Votues |
| **LV** | Lista e Votuese |
| **ZFK** | Zarfi i Fletëvotimit me Kusht |
| **FPR** | Formulari i Përputhjes së Rezultateve |
| **FRK** | Formulari i Rezultateve të Kandidatëve |
| **DAP** | Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes |
| **DOZ** | Departamenti i Operacioneve Zgjedhore |
| **DTI** | Departamenti i Teknologjisë Informative |
| **DKT** | Departamenti i Koordinimit ne teren |
| **KOZ** | Këshilli për Operacione Zgjedhore |
| **KP** | Këshilli për Personel |
| **KBF** | Këshilli për Buxhet dhe Financa |
| **KA** | Komiteti i Auditimit |
| **KÇL** | Këshilli për Çështje Ligjore |
| **KMJ** | Këshilli për marrëdhënie me jashtë |
| **ZRPP** | Zyra për Regjistrim të Partive Politike |

# 1 KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE E KQZ-SË

## 1.1 Baza ligjore

KQZ-ja është organ i përhershëm dhe i pavarur, i përcaktuar me nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës[1].

Me qëllim të organizimit të zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës, për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe ligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Aspektin e financimit të subjekteve politike e rregullon Ligji për Financimin e Partive Politike. Ai rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës.

## 1.2 Mandati i KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

**Kompetencat e KQZ-së**

Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja:

a) *ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për zgjedhjet dhe pjesëmarrjen to;*

b) *ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;*

c) *krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe*

d) *kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.*

[1] Kapitulli XII [Institucionet e Pavarura], Neni 139 , Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

## 1.3 Përbërja dhe struktura KQZ-së

Përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përcaktuar me Kushtetutë[2]. Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli. Gjashtë anëtarë të tjerë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend. Një anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb të Kosovës, dhe tre anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë. Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, Komisionit i ndihmon Sekretariati i KQZ-së.

## 1.4 Sekretariati i KQZ-së

Sekretariati i KQZ-së është një trupë administrative-teknike, e themeluar nga KQZ-ja për të ndihmuar KQZ-në në kryerjen e përgjegjësive dhe të funksioneve të saj. SKQZ-ja i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatit raporte dhe rekomandime për KQZ-në.

## 1.5 Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFPP)

KQZ-ja në pajtueshmëri me ligjin, ka themeluar Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Partive Politike dhe Certifikim (ZRCKFPP), është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe azhurnimin e Regjistrit të Partive Politike, për certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për zgjedhje, certifikimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, kufizimin e shpenzimeve të subjekteve të certifikuara politike gjatë fushatave, si dhe pranimin e deklarimeve të financave të kandidatëve për zgjedhje.

## 1.6 Komisionet Komunale të Zgjedhjeve

KKZ-të janë trupa të themeluara nga KQZ-ja në tridhjetetetë (38) komunat e Republikës së Kosovës për të ndihmuar në organizimin e zgjedhjeve. Ato janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve përbrenda komunave, nën mbikëqyrjen dhe udhëzimet e KQZ-

[2]. Neni 139, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

së nëpërmjet Sekretariatit, me qëllim të garantimit të ligjshmërisë, legjitimitetit dhe efikasitetit të procesit zgjedhor.

## 2 PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË PUNËS - METODOLOGJIA

Për hartimin e Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2023 janë marrë për bazë një numër faktorësh:

- *Ligji Nr. 08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;*
- *Plani Strategjik i KQZ-së 2023 – 2026;*
- *Aktivitetet e parealizuara në vitin 2023;*

Ligji i ri për zgjedhjet i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2023 ka zgjeruar detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në organizimin e proceseve zgjedhore. Detyrimet e reja që dalin nga ky ligj, janë përfshirë në aktivitete konkrete të cilat duhet të realizohen me qëllim që të bëjnë të mundur zbatimin e këtyre përgjegjësive ligjore.

Gjatë hartimit të Planit të Punës janë marrë për bazë rekomandimet e evidentuara në raportet e monitorimit të zgjedhjeve të fundit të vëzhguesve të Bashkimit Evropian dhe Koalicionit të OJQ-ve Demokracia në Veprim përbrenda kornizës aktuale ligjore.

Plani synon që të përmirësojë proceset dhe shërbimet e KQZ-së në funksion të përgatitjes për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale që do të mbahen.

## 3 PLANI I PUNËS SIPAS SHTYLLAVE STRATEGJIKE TË KQZ-së

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2024 janë të strukturuar sipas shtyllave strategjike të parapara në Planin Strategjik të KQZ-së për periudhën 2023 – 2026, siç paraqiten në tabelën vijuese:

| SHTYLLA STRATEGJIKE | NUMRI I AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA |
|---|---|
| **Qëndrueshmëria dhe fuqizimi institucional** | **30** |
| **Korniza ligjore** | **3** |
| **Gjithpërfshirja dhe pjesëmarrja në zgjedhje** | **15** |
| **Inovacioni dhe teknologjia** | **7** |
| **Bashkëpunimi dhe transparenca** | **16** |
| Total: | **71** |

## 4 Raportimi

Me qëllim të shqyrtimit të progresit në zbatim të Planit të Punës, raportim i rregullt bëhet në baza tre mujore. Ndërsa, raportimet tjera mund të bëhen sipas kërkesës.

Raporti tre mujor prezantohet nga bartësit e aktiviteteve para KQZ-së pasi që të përgatitet raporti nga personat përgjegjës.

Në muajin qershor, pas raportimit të dytë të zbatimit të Planit të Punës KQZ bën vlerësimin e zbatimit dhe sipas nevojës rishikon Planin. Pastaj, në fund të vitit, hartohet edhe një raport i konsoliduar vjetor (Raporti vjetor) i cili mund të bëhet publik, gjegjësisht të publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Në periudhën e ndërmjetme mund të mbahen takime të rregullta ndërmjet KQZ-së dhe drejtuesve të njësive të saj strukturore te SKQZ-së dhe do të vlerësohet procesi i zbatimit të Planit të Punës. Në fund të vitit raportues, KQZ dhe drejtuesit e njësive të saj strukturore të SKQZ-së mbajnë mbledhjen ku pjesëmarrësit prezantojnë dhe vlerësojnë raportet përmbledhëse për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara me Planin e Punës, si dhe zbatimin e aktiviteteve të tjera mbështetëse.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | Raportimi tre mujor i realizimit te planit te punes se KQZ 2024 | Pas çdo periudhe tre mujore, Sekretariati përgatitë raport për KQZ-në lidhur me implementimin e Planit të Punës për periudhën përkatëse. Së bashku me Raportimin tre mujor të zbatimit të planit të punës përgatitet raporti i shepnzimeve pas përfundimit te çdo tre mujori të vitit fiskal. Raportimi tre mujor i realizimit të planit të punës është një mjet i rëndësishëm për të monitoruar dhe vlerësuar progresin e e aktiviteteve gjatë një periudhe të caktuar.<br><br>Vlerësimi periodik dhe përfundimtar i realizimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 është një proces i rëndësishëm që ndihmonë në vlerësimin e efikasitetit dhe arritjeve të institucionit gjatë një periudhe të caktuar.<br><br>Vlerësimi përfundimtar i realizimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 pasqyron qëllimet, objektivat dhe detyrat e përcaktuara në planin e punës për periudhën e caktuar 01 janar – 31 dhjetor 2023. Vlerësimi i realizimit periodik dhe përfundimtar të planit të punës së KQZ lidhet me arritjet dhe progresin e çdo qëllimi, objektivi dhe detyre të përcaktuar në plan. Këto të dhëna mund të përfshijnë raporte të brendshme, analiza, dhe vlerësime si dhe përqindja e realizimit të aktiviteteve sipas shtyllave dhe terësinë e gjithë aktiviteteve. Po ashtu pasqyron çdo ndryshim në kursin e veprimeve dhe shpjegohen arsyet pse ka ndodhur.<br><br>Plani përditësohet në menyrë periodike dhe për realizimin e planit të punës së KQZ duhet të identifikohen faktorët që kanë ndihmuar në arritjen e qëllimeve dhe objektivave dhe çdo problem ose sfidë që ka penguar progresin dhe arritjet. | Kryeshefi Ekzekutiv | Kryeshefi Ekzekutiv | KOZ/KQZ | | | | | | | | | | | | | T1, T2, T3 | 1. Raport periodik për tre mujorin T1, T2, T3 – Raport i hartuar dhe miratuar<br>2. Vlerësimi përfundimtar i realizimit të planit të punës së KQZ për vitin 2024 raportohet në muajin janar 2025 dhe përfshin raportimin për periudhat T1, T2, T3, T3 dhe T4 - Raport i hartuar dhe miratuar. | | Pa kosto | |
| 8 | Raporti vjetor i punes i KQZ-së për vitin 2023 për Kuvendin e Republikës së Kosovës | Raporti vjetor i punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për vitin 2023 së bashku me raportin vjetor financiar, është një dokument zyrtar i KQZ që përfshin një përshkrim, analizë dhe vlerësim të punës së KQZ-së për vitin 2023, i cili është një mjet transparence dhe llogaridhënie përpara publikut, institucioneve të tjera dhe donatorëve ndërkombëtarë. Raporti vjetor i punës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) bazohet në shumë elementë që përfshijnë aktivitetet dhe proceset e kryera nga KQZ gjatë një periudhe vjetore që përbazë ka planin e punës së KQZ për vitin 2023 dhe përfshin:<br>- Detajet mbi përgatitjet dhe organizimin e zgjedhjeve të mbajtura gjatë vitit;<br>- Përshkrimi i procesit të regjistrimit të votuesve dhe pjesëmarrjes së tyre;<br>- Informacion mbi krijimin dhe menaxhimin e regjistrave të Subjekteve Politike, përfshirë azhurnimet dhe përmirësimet;<br>- Ndryshimet në legjislacionin zgjedhor dhe rregulloret e ndryshuara që kanë ndikuar në punën e KQZ-së;<br>- Informacion mbi buxhetin e KQZ-së dhe përdorimin e burimeve financiare gjatë vitit;<br>- Përshkrimi i teknologjive dhe inovacioneve të përdorura për përmirësimin e proceseve zgjedhore;<br>- Raportimi mbi bashkëpunimin e KQZ-së me institucionet tjera, organizatat ndërkombëtare dhe pjesëmarrësit në procesin zgjedhor;<br>- Vlerësimi i performancës së KQZ-së në përmbushjen e detyrave dhe qëllimeve të saj;<br>- Identifikimi i sfidave dhe problematikave të hasura gjatë vitit;<br>- Rekomandime për përmirësimet e mundshme dhe hapat që mund të ndërmerren në të ardhmen. | Grupi Punues | Zëdhënësi i KQZ | KOZ / KÇL / KBF / KQZ | | | | | | | | | | | | | T1,T2 | 1. Raporti vjetor i punes i KQZ-së për vitin 2023 - Raport i hartuar dhe aprovuar<br>2. Raporti vjetor i punes i KQZ-së për vitin 2023 i dorëzuar në Kuvendin e Kosovës së bashku me raportin vjetor financiar për vitin 2023. | KQZLigji per zgjedhje / kuvendi | Pa kosto | KQZ |
| 9 | Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2025 - 2027 | Korniza Afatmesme të Shpenzimeve 2025- 2027 është dokument qe i paraprinë procesit buxhetor dhe shërben për realizimin e strategjisë dhe qëllimeve të KQZ-se përmes objektivave qe realizohen përmes aktiviteteve dhe projekteve ne një vit të rregullt buxhetor. Fokusi në përgatitjen e KASH-it duhet të përqëndrohet në krijimin e një kornize për zhvillimin e një buxheti të qëndrueshëm të KQZ-së për periudhën 2025-2027 dhe që mundëson financimin e prioriteteve kyçe të përcaktuara me Pln strategjik dhe Ligjin për Zgjedhjet. Ky dokument në MFPT dorëzohet ne fund të muajit mars. | DAP | ZKF | KBF/KQZ | | | | | | | | | | | | | T1 | 1. Hartimi i KASH 2025-2027 për krijimin e një kornize për zhvillimin e një buxheti të qëndrueshëm të KQZ-së – hartuar dhe miratuar.<br>2. Dokumenti i dërguar në Ministrinë e Financave. | KQZ / MFPT | Pa kosto | KQZ |
| 10 | Raportimi tre mujor financiar i shpenzimeve të buxhetit të KQZ për vitin 2024 | Pas çdo periudhe tre mujore të vitit fiskal, Sekretariati përgatitë raport për KQZ-në. Raportet tre mujore dhe raporti vjetor shpalos pasqyrat financiare dhe nivelin e shpenzimeve të buxhetit për vitin fiskal 2024.<br>Raportimi tre mujor T1, T2, T3 dhe T4 raporti vjetor financiar i shpenzimeve të buxhetit të KQZ për vitin 2024 përfshinë periudhën e caktuar 01 janar – 31 dhjetor 2024. Raporti përfundimtar vjetor financiar i shpenzimeve të buxhetit të KQZ për vitin 2024 përgatitet dhe raportohet në muajin janar të vitit 2025. | DAP | ZKF | KBF/KQZ | | | | | | | | | | | | | T2, T3, T4 | 1. Raport periodik i shpenzimeve për tre mujorin T1, T2, T3 – Raport i hartuar dhe miratuar<br>2. Raporti vjetor financiar i shpenzimeve të buxhetit të KQZ për vitin 2024, raportohet në muajin janar 2025 dhe përfshin raportimin për periudhat T1, T2, T3, T3 dhe T4 - Raport i hartuar dhe miratuar. | LPP | | KQZ |
| 11 | Zbatimi i Planit të prokurimit për vitin 2024 | Zbatimi i Planit të Prokurimit është një proces i rëndësishëm që kërkon koordinim dhe menaxhim efikas për të siguruar që blerjet e organizatës buxhetore janë të efektshme dhe të përputhshme me qëllimet dhe politikat e përgjithshme të organizatës buxhetore. Pas çdo periudhe tre mujorel, Sekretariati përgatitë raport për KQZ-në. Raportet tre mujore dhe raporti vjetor shpalosin zbatimin e aktivitete të prokurimit sipas planit përfundimtar të prokurimit dhe kërkesave buxhetore për vitin 2024.<br>Raportimi tre mujor T1, T2, T3 dhe T4 raporti përfudnimtar i realizimit të Planit të prokurimit për vitin 2024 përfshinë periudhën e caktuar 01 janar – 31 dhjetor 2024. Raporti përfundimtar i realizimit të Planit të prokurimit për vitin 2024 përgatitet dhe raportohet në muajin janar të vitit 2025. | | | | | | | | | | | | | | | | T1, T2, T3, T4 | 1. Raport periodik i realizimit të planit përfundimtar të prokurimit për tre mujorin T1, T2, T3 – Raport i hartuar dhe miratuar<br>2. Raporti përfundimtar i realizimit të planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2024, raportohet në muajin janar 2025 dhe përfshin raportimin për periudhat T1, T2, T3, T3 dhe T4 - Raport i hartuar dhe miratuar. | LPP | Pa kosto | KQZ |
| 12 | Rishikimi i Planit të Punës së KQZ 2024 | Rishikimi i Planit të Punës është një proces i vazhdueshëm që KQZ mund të bëjë për të siguruar se aktivitetet dhe qëllimet janë të përshtatshme dhe efektive. Kjo përfshin shqyrtimin periodik të objektivave, strategjive dhe aktiviteteve për të siguruar se ato janë të përshtatshme për periudhën aktuale dhe sigurimi që plani i punës përputhet me nevojat dhe pritjet e KQZ. | Kryeshefi Ekzekutiv | Kryeshefi Ekzekutiv | KOZ / KQZ | | | | | | | | | | | | | T2 | 1. Plani i veprimit zbatimit të aktiviteteve të planit të punës për periudhën gjashtë mujore – Raportim dhe miratim<br>2. Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve të planit të punës për periudhën gjashtë mujore – Raport i hartuar dhe miratuar<br>3. Rishikimi i Planit të Punës së KQZ 2024 - Rekomandime | n/a | Pa kosto | KQZ |
| 13 | Hartimi i Planit të Buxhetit 2025-2027 | Pas shqyrtimit të KASH 2025-2027 nga Kuvendi i Kosovës, fillon procesi i hartimit të Planit të Buxhetit 2025-2027 të KQZ-së. Hartimi i Planit të Buxhetit bazohet ne kërkesat buxhetore të cilat janë të bazuara ne plane dhe projekte të njësive kërkuese të KQZ-së. Planifikimi i buxhetit për vitin 2025 dhe projeksonet për vitet 2026 dhe 2027 bazohen në objektivat e KQZ-së dhe në KASH 2025-2027. Hartimi i planit të buxhetit fillon me lëshimin e Qarkorës së parë buxhetore dhe procesi zhvillohet deri në aprovim të Ligjit të buxhetit nga Kuvendi. | DAP | ZKF | KBF/KQZ | | | | | | | | | | | | | T2,T3,T4 | 1.Hartimi i dokumentit me kërkesat buxhetore,<br>2.Shqyrtimi dhe aprovimi i buxhetit,<br>3. Plani i dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kohë. | LMFPP | Pa kosto | KQZ |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 39 | Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinjë | Ka për qellim informimin dhe edukimin e votuesve të rinj, për të drejtën e tyre për të zgjedhë dhe për tu zgjedhur, procesin zgjedhor, sistemin dhe procedurat zgjedhore dhe ndikimin që mund të ketë vota e tyre në zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Përmbushja e objektivave do të arrihet përmes organizimit të ligjëratave, diskutimeve, simulimit të votimit, shpërndarjes së materialeve informuese/vetëdijesuese të cilat do të organizohen në të gjitha komunat, nga të cilat mund të përfitojnë direkt rreth 23,000 maturantë. Projekti është i maratuar mbetet të zabtohet. | DOZ | Udhëheqësi I Divizionit për Informim | KOZ/KQZ | T1,T2 | Realizimi i aktiviteteve në: Sallat e asambleve komunale; Shtëpitë e kulturës; Zyrat e këshillave të veprimeve rinore; Zyrat e qendrave rinore; dhe Shkollat e mesme. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete. Përgatitja e raportit përmbledhës mbi zbatimin e projektit. | Plani Strategjik | 20,000.00 | Buxheti i KQZ-së |
| 40 | Zhvillimi i përmbajtjes për Edukim/Informim dhe Trajnimin Digjital | Qëllimi i realizimit të kësaj platforme është që çdo qytetari të interesuar t'i ofrojë mundësi për informim online për të drejtën e votës dhe procesin zgjedhor dhe trajnimin e administratës zgjedhore.<br>Secili shfrytëzues i platformës mund të mësoj pasi të përzgjedh temën e cila është në interesin të tij/saj dhe të njëjtën ta ndjekë në cilën do kohë që i përshtatet atij/ asaj dhe nga vendi kudo që gjindët.<br>Kjo platformë online do të mundëson informimin dhe edukimin e votuesve, trajnimin e trupave zgjedhor, testimin, vlerësimin dhe certifikimin e tyre. OSBE do të kontrakton OE për zhvillimin e platformës online për informim/edukim të votuesve dhe trajnim të TMZ-ve dhe vëzhguesve. | DOZ/ZRCKFSP | Udhëheqësi I Divizionit për Informim | KOZ/KQZ | T1, T2, T3, T4 | Platforma do të përdoret për: 1. Informimin dhe edukimin e votuesve për të drejtat e tyre. 2. Trajnimin e administratës së zgjedhjeve në aspekte të ndryshme të rolit dhe përgjegjësive të tyre në proceset zgjedhore. 3. Informimi dhe trajnimi i vëzhguesve të zgjedhjeve | Plani Strategjik /LZP | Me kosto | OSBE |
| 41 | Fushatë ndërgjegjësuese për promovimin barazisë gjinore në proceset zgjedhore | Në përpjekje për të promovuar barazinë gjinore dhe për të rritur pjesëmarrjen e grave/vajzave në proceset demokratike, do te realizohet një projekt për inkurajimin e grave/vajzave për pjesëmarrje aktive në proceset zgjedhore. Përmes këtij projekti do te organizohen një seri e punëtorive. Projekti do të realizohet në shtatë qendrat regjionale. Përmes këtyre punëtorive grave/vajzave do tu ofrohen informacione thelbësor mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje si votuese duke i pajisur ato me njohuri praktike rreth zgjedhjeve. ne keto puntori | DOZ | Udhëheqësi I Divizionit për Informim | KOZ/KQZ | T2, T3 | 1. Rritja e pjesëmarrjes së femrave përmes punëtorive të organizuara për zgjedhjet ardhshme. 2. Përgatitja e raportit përmbledhës mbi zbatimin e projektit. | Plani Strategjik | 15,000.00 | OSBE |
| 42 | Shqyrtimi i planeve orientuese operacinale te zgjedhjeve te rregullta | Hartimi i planeve te detajuara te aktiviteteve zgjedhore sipas llojit dhe afatit | SKQZ | KOZ/KQZ | KQZ | T1, T2 | Planet e detajuara te aktivitetev ligjore dhe operacionale per secilin lloj te zgjedhjeve | Plani Strategjik | Pa kosto | Buxheti I KQZ-së |
| 43 | Permirësimi dhe përditësimi i listës së votuesve. | Raport tremujor statistikor lidhur me ndrimin e qendrave te votimit. Gjithashtu do te behet edhe analizimi i te dhenave te votuesve me qellim te verfikimit te integimit te sistemit unik te adresave ne dhenat e votuesve. Analiza vjetore e bazes se te dhenave te deparatamentin te pensioneve. | DOZ | Udhëheqësi I Divizionit për Sherbim Votues | KQZ | T1, T2 | 1. Përqindja e votuesve të caktuar në QV bazuar në adresa. 2. Numri i votuesve të caktuar në bazë të sistemit të adresave që kërkojnë ndërrim e qendrës së votimit.. | Plani Strategjik | Pa kosto | |
| 44 | Identifikimi dhe Vlerësimi i Qendrave te Votimit Jashtë Vendit | KQZ do të bëjë se paku tre (3) vizita zyrtare nga duke përfshirë tre (3) njësi të SKQZ-së neper ambasada jashtë vendit, dhe përmes raportit për vlerësimin e QV-ve me rekomandimet për mënyrën e votimit, KQZ synon që të zbatoj sa me mire dhe me lehte votimin jashtë vendit duke respektuar dispozitat ligjore dhe rritjen e besimit e transparences tek publiku, me qellim rritjen e numrit te qytetareve që realizojnë te drejtën e votimit nga jashtë Kosove. | KQZ/DKT/DOZ/DTI | Zyrtaret Ekzekutiv të KKZ-së dhe Udhëheqësi I Divizionit për Sherbim Votues | KOZ/KQZ | T1, T2, T3, T4 | 1. Hyrja ne fuqi e Rregullorve të KQZ-se sipas risive të LZP-së, 2. Themeilimi I numrit te QV-ve dhe votimi jashte vendit, ndjekja e praktikave te mira per administrim dhe menaxhim te procesit zgjedhor, ne raport me zbatimin e procedurave te LZP-së. | Plani Strategjik / LZP | 10,000.00 | Buxheti i KQZ-së |
| 45 | Analizë e Qendrave të Votimit brenda Vendit | Pas shqyrtimit të analizës për QV aktuale, SKQZ përmes ZEKZ-ve do t'i shqyrtoj propozimet për themelimin e QV-ve te reja apo edhe fuzionimin e QV-ve aktuale. Me qellim që votuesit të kenë mundësi të votojnë me afër vendbanimeve të tyre, përmes planeve sipas praktikave të mira të përmirësojmë kushtet për votim, duke krijuar kushte për votuesit neper Qendra Votimi dhe Vendvotime për zhvillimin e votimit. | DKT/DOZ | Zyrtaret Ekzekutiv të KKZ-së dhe Udhëheqësi I Divizionit për Sherbim Votues | KOZ/KQZ | T1, T2, T3, T4 | 1. Hyrja ne fuqi e Rregullorve të KQZ-se sipas risive të LZP-së, 2.Votimi brenda vendit, ndjekja e praktikave te mira per administrim dhe menaxhim te procesit zgjedhor, ne raport me zbatimin e procedurave te LZP-së. | Plani Strategjik / LZP | Pa kosto | Buxheti i KQZ-së |
| 46 | Fushatë senzibilizuese për pjesmarrje në zgjedhje të komuniteteve joshumicë | Analize e problemeve dhe nevojave dhe hartimi i planit te veprimit per komunitetet joshumice | DOZ | Udhëheqësi I Divizionit për Informim | KOZ/KQZ | | 1. Numri i aktiviteteve të realizuara me grupet e synuara. 2. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete. 3.Rritja e pjesëmarrjes se komuniteteve joshumicë në krahasim me zgjedhjet paraprake. | Plani Strategjik | Me Kosto | Buxheti i KQZ-së |
